



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

MINISTRI

Nr. 8217 Prot.

Tiranë, më 27.07. 2018

URDHËR

Nr. 457, datë 27.07.2018

PËR


RIORGANIZIMIN E PROGRAMIT TË INTEGRUAR TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË “MASTER I SHKENCAVE” NË “STOMATOLOGJI DHE PROTEZA DENTARE”, TË KOLEGJIT UNIVERSITAR “REALD”.

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, nenit 35, 75 dhe 80 të Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Riorganizimin e programit të integruar të studimit të ciklit të dytë “Master i Shkencave” në “Stomatologji”, me 300 kredite, në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 5 vite akademike (10 semestra), i akredituar, si ndryshime në masën 20 përqind, bazuar në vendimin e Senatit Akademik nr. 04/1, datë 22.01.2018, të Kolegjit Universitar “Reald”, në program të përbashkët studimi në “Stomatologji dhe Proteza Dentare”, me Universita degli Studi di Foggia, në gjuhë shqipe/italiane, me formë studimi me kohë të plotë, me 360 kredite, me kohëzgjatje normale 6 vite akademike (12 semestra), në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e përbashkët e programit të integruar të studimit të ciklit të dytë “Master i Shkencave” në “Stomatologji dhe Proteza Dentare” nga Kolegji Universitar “Reald” dhe Universita degli Studi di Foggia.
2. Veprimtaria akademike për programin e riorganizuar, program i integruar i studimeve të ciklit të dytë të studimit në “Stomatologji dhe Proteza Dentare”, fillon në vitin akademik 2018-2019.
3. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion.
4. Kolegji Universitar “Reald” të zbatojë procedurat e aplikimit për regjistrimin dhe ndryshimin e formës dhe përmbajtjes së diplomës ekzistuese pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore.
5. Ngarkohet për zbatimin e këtij Urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Derregullimit, Lejeve, Licensave dhe Monitorimit në Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Kolegji Universitar “Reald”.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
MINISTRI

Nr. 8223 Prot.

Tiranë, më 27.07.2018

URDHËR

Nr. 463, datë 27.07.2018

PËR

**RIORGANIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË
“BACHELOR” NË “INFIERMIERI”, TË KOLEGJIT UNIVERSITAR “REALD”.**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, nenit 35, 73 dhe 80 të Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Riorganizimin e programit të studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Infermieri”, me 180 kredite, në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 3 vite akademike (6 semestra), i akredituar, si ndryshime në masën 20 përqind, bazuar në vendimin e Senatit Akademik nr. 04/1, datë 22.01.2018, të Kolegjit Universitar “Reald”, në program të përbashkët studimi me Universita degli Studi di Foggia, në gjuhë shqipe dhe italiane, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 3 vite akademike (6 semestra), në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e përbashkët “Bachelor” në “Infermieri” nga Kolegji Universitar “Reald” dhe Universita degli Studi di Foggia.
2. Veprimtaria akademike për programin e riorganizuar të ciklit të parë të studimit në “Infermieri”, fillon në vitin akademik 2018-2019.
3. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion.
4. Kolegji Universitar “Reald” të zbatojë procedurat e aplikimit për regjistrimin dhe ndryshimin e formës dhe përmbajtjes së diplomës ekzistuese pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore.
5. Ngarkohet për zbatimin e këtij Urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Derregullimit, Lejeve, Licensave dhe Monitorimit në Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Kolegji Universitar “Reald”.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI
Lindita Nikollaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
MINISTRI

Nr. 229 Prot.

Tiranë, më 27.07 2018

URDHËR

Nr. 469, datë 27.07.2018

PËR


**RIORGANIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË
“BACHELOR” NË “FIZIOTERAPI”, TË KOLEGJIT UNIVERSITAR “REALD”.**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, nenit 35, 73 dhe 80 të Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Riorganizimin e programit të studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Fizioterapi”, me 180 kredite, në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 3 vite akademike (6 semestra), i akredituar, si ndryshime në masën 20 përqind, bazuar në vendimin e Senatit Akademik nr. 04/1, datë 22.01.2018, të Kolegjit Universitar “Reald”, në program të përbashkët studimi me Universita degli Studi di Foggia, në gjuhë shqipe dhe italiane, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 3 vite akademike (6 semestra), në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e përbashkët “Bachelor” në “Fizioterapi” nga Kolegji Universitar “Reald” dhe Universita degli Studi di Foggia.
2. Veprimtaria akademike për programin e riorganizuar të ciklit të parë të studimit në “Fizioterapi”, fillon në vitin akademik 2018-2019.
3. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion.
4. Kolegji Universitar “Reald” të zbatojë procedurat e aplikimit për regjistrimin dhe ndryshimin e formës dhe përmbajtjes së diplomës ekzistuese pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore.
5. Ngarkohet për zbatimin e këtij Urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Derregullimit, Lejeve, Licensave dhe Monitorimit në Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Kolegji Universitar “Reald”.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.



Lindita Shkolla